




BASHKIA FUSHË - ARRËZ	
Nr. 1317	prot. Dt. 15.05.25
Ref: Këshilli Bashkiak	
	

Georgj e Sautaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr.332/1 prot.

Shkodër, më 15.05.2025

Lënda: Mbi Vendimin e Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz Nr.16, datë 28.04.2025.

KËSHILLI BASHKIAK FUSHË ARRËZ

Prefekti përcaktuar në dispozitat e ligjit Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8 germa a, neni 16, Urdhërit të Kryeministrit Nr.21, datë 5.02.2025 "Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut", Urdhëri i MB Nr. 39, datë 20.02.2025 "Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut" Aneksi I "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, neni 24, neni 54/n, neni 55/2, neni 64 germa c, të ligjit Nr.22/2018 "Për strehimin social" i përditësuar, VKM Nr.362/2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qerasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qerasë në treg të lirë.....", shqyrtoi vendimin e Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz Nr.16, datë 28.04.2025 "Për një ndryshim në VKB Nr.6/2025 për miratim të listës së familjeve që do të përfitojnë subvencion qeraje në bashkinë Fushë Arrëz për vitin 2025".

Pas trajtimit, Prefekti ju autorizon procedim të mëtejshëm për ndryshim të masës së subvencionit të qerasë, por vlera prej 20% ose 620.280 lekë që financon vetë bashkia e shprehur në vendim, i mungon burimi i financimit (artikulli/grup/titull buxhetor) në zbatim të vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 64/2024 "Buxheti i vitit 2025". Për këtë nevojitet një tjetër vendim i KB me efekt financiar.

Sekretari i KB duhet të ketë në vëmendje të theksuar procedurën sipas rregullores së KB e miratuar me VKB Nr.15, datë 27.04.2020, neni 66.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T I

Majlinda ANGONI

